

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
VITI 2026**

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Natyra e kërimit	Objekti i kërkesës (përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Përgjigje (përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Data e kthimit të përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (përgjigjja jepet e plotë / e kufizuar / e deleguar)	Tarifa
60.	01.04.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti interesohet nëse është përfitues nga ligji nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”, me qëllim shuarjen e masës administrative ndaj tij.	Pas verifikimeve të kryera, rezultoi se subjekti nuk ishte përfitues, kjo sipas parashikimeve (kushteve) që normohen në nenin 2, pika 2 e ligjit nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”.	03.04.2026	e plotë	nuk ka
61.	01.04.2026	Kërkesë për informacion	Sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë vitit 2022, nga subjekti “F**** F****” janë importuar produkte të markës “W****”, ku është konstatuar prania e ‘ <i>Listeria ST155</i> ’.	Gjetja dhe rekomandimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), lidhur me produktet “W****” se nuk kanë qenë të shoqëruara me certifikatën e detyrueshme veterinare sipas modelit OVI-Y, nuk është pranuar, kjo pasi:	16.04.2026	e plotë	nuk ka

			<p>Përveç problematikës së gjurmueshmërisë së produktit, në raport evidentohet gjithashtu se këto produkte nuk kanë qenë të shoqëruara me certifikatën e detyrueshme veterinare sipas modelit OVI-Y.</p> <p>Në këtë kuadër, kërkojmë informacion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A është marrë masë administrative ndaj subjektit, për mungesën e certifikatës OVI-Y ? 2. Nëse po, cilat janë masat konkrete? 	<ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në Certifikatën për produktet e mishit dhe stomakët dhe zorrët për dërgim në Republikën e Shqipërisë, Ju informojmë se kemi të bëjmë me një certifikatë që është për certifikimin e produkteve të mishit, e jo sikurse ndryshe pretendohet nga Grupi Auditues i KLSH-së se duhet të shoqërohen me model OVI-Y, <u>model i cili, është për kafshë të gjalla dhen dhe dhi, për therje të menjëhershme pas importit;</u> • Në zbatim të Urdhrit nr.328, datë 22.11.2011 “Për miratimin e Rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve” si dhe Urdhrit nr.174, datë 23.04.2021 “Për disa ndryshime në Rregulloren “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshëve dhe mishit të freskët të tyre, të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.328, datë 22.11.2011”, nuk ka modele të certifikatave për produktet, por vetëm për kafshët e gjalla thundrake dhe mishin e freskët të tyre. <p>Në rastin konkret kemi të bëjmë me produktin <i>mish pule</i>, përkrahur në pikën 1.28 të certifikatës ku përcaktohet specia Gallus Gallus, pra, janë specie të pulave nga të cilat është marrë lënda e parë për përpunimin e produktit salcice.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

62.	03.04.2026	Kërkesë për punësim	<p>Subjekti interesohet për t'u punësuar pranë drejtorisë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, qarku Tiranë ose Durrës.</p> <p><i>Bashkëlidhur kërkesës së ardhur, gjendet edhe CV përkatëse.</i></p>	<p>Vendet vakante të institucionit publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në web-in: <u>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit</u> (www.aku.gov.al), seksioni 'Rreth Nesh' > 'Mundësi punësimi' > 'Shpallje për vende të lira pune'.</p> <p>Çdo shpallje e pozicioneve vakante përmban informacionin e duhur dhe të plotë në lidhje me pozicionin e lirë, sektorin dhe drejtorinë përkatëse, kategorinë e pagës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi arsimin, përvojën, etj., si dhe rregullat mbi afatin, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar.</p>	07.04.2026	e plotë	nuk ka
63.	07.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti kërkon informacionin e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i kontrolleve të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në tregjet e fruta-perimeve dhe ushqimeve në Tiranë, përgjatë viteve 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025; 2. Numri i shkeljeve të konstatuara për secilin vit; 3. Lloji i shkeljes dhe tregu ku është konstatuar. 4. Masat përkatëse të marra për çdo rast. 	<p><i>Në lidhje me kontrollet e kryera në tregjet e fruta-perimeve dhe ushqimeve në Tiranë,</i> rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin 2021 janë kryer gjithsej 29 (njëzet e nëntë) inspektime; • Në vitin 2022 janë kryer gjithsej 14 (katërmëdhjetë) inspektime; • Në vitin 2023 janë kryer gjithsej 12 (dymbëdhjetë) inspektime; • Në vitin 2024 janë kryer gjithsej 10 (dhjetë) inspektime; dhe • Në vitin 2025 janë kryer gjithsej 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) inspektime. <p><i>Në lidhje me numrin e shkeljeve të konstatuara për secilin vit,</i> rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin 2021 janë konstatuar në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) shkelje; • Në vitin 2022 janë konstatuar në total 2 (dy) shkelje; 	22.04.2026	e plotë	nuk ka

			<ul style="list-style-type: none">• Në vitin 2023 janë konstatuar në total 2 (<i>dy</i>) shkelje;• Në vitin 2024 janë konstatuar në total 1 (<i>një</i>) shkelje; <i>dhe</i>• Në vitin 2025 janë konstatuar në total 44 (<i>dyzet e katër</i>) shkelje. <p><i>Në lidhje me llojin e shkeljeve dhe tregjet në të cilat janë konstatuar, ndër arsyt kryesore rendisim:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• Rinovim librezash shëndetësore, sistemin ambientit, rinovim analizash uji, rinovim i shërbimit DDD;• Mungesa e gjurmueshmërisë;• Produkte pa etiketë në gjuhën shqipe;• Produkt 'mish' pa vulë dhe pa certifikatë veterinare;• Mungesë e kushteve higjiëno-sanitare; etj. <p><i>Këto shkelje, janë konstatuar në:</i> Tregun Agro-Ushqimor, Tregun e Qytetit të Kavajës, Tregun e ndodhur tek ish-“Uzina Dinamo”, Tregun e ndodhur në Rrugën “Hamdi Pepa” dhe Tregun e ndodhur në rrugën “Vasil Shanto”.</p> <p><i>Në lidhje me masat përkatëse të marra,</i> për çdo rast ku janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, ndaj subjekteve përkatëse janë vendosur masat administrative '<i>Paralajmërim</i>' dhe '<i>Gjobë</i>', duke u shoqëruar me bllokim të produkteve, konform legjislacionit në fuqi.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

64.	07.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Referuar bllokimit të produktit ‘Turshi’ në doganën Morinë, Kukës, ku nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është vendosur se ngarkesa do të qëndrojë e bllokuar deri në daljen e rezultatit të analizave, subjekti kërkon informacion sa më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kur produkti vjen nga Republika e Kosovës, përse nuk zbatohet VKM-ja nr.480, datë 30.08.2023? A prevalon një Urdhër apo një Rregullore, mbi VKM-në? 2. A ka të drejtë subjekti të informohet se ku do të kryhen analizat, në cilin laborator dhe se për çfarë do të analizohet produkti? 3. A duhet të njoftohet subjekti për kohëzgjatjen e përgjigjes së analizave? Kujtojmë se produktet kanë afat skadence. 4. A ka të drejtë subjekti të mos pranojë rezultatin e analizës Tuaj kur ajo merret pa Procesverbal dhe pa kodifikim të mostrës? 5. Nëse subjektet nuk janë dakord me rezultatet e analizave Tuaja, a 	<p>Procedurat e kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) për produktet ushqimore, kryhen në zbatim të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Konkretisht, për produktin ‘Turshi’, zbatohen kërkesat ligjore të Urdhrit të Ministrit nr.374, datë 31.08.2017 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.72, datë 15.03.2011 “Për miratimin e Akt-Kontrollit “Mbi inspektimin e produkteve me origjinë jo-shtazore në Pikat e Inspektimit Kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre” dhe Akt ‘Marrje Mostre””.</p> <p>Bazuar Planit të Monitorimit të Marrjes së Mostrave për produktet ‘Turshi’ në Pikat e Inspektimit Kufitar dhe në Terren, procedura lidhur me bllokimin e produktit deri në daljen e rezultateve laboratorike, bazohet në Urdhrin nr.374, datë 31.08.2017 e Ministrit (të sipërcituar), sipas të cilit, specifikohet në Akt-Kontroll, si vijon:</p> <p>Ky Akt-Kontrolli ka vlerë për zhdoganimin e ngarkesës. Subjekti, pronar i mallit, ka të drejtë shitje të produktit ushqimor pas përfundimit të analizave laboratorike. Pra, akti administrativ që subjektet përkatëse kryejnë zhdoganimin e ngarkesave, përcakton këtë procedurë e për rrjedhojë, procedurat e ndjekura janë kryer konform kërkesave ligjore. Po kështu, Urdhri i lartëpërmendur përcakton edhe Aktin e Marrjes së Mostrës, i cili mbahet nga inspektori i PIK, së bashku me Fletën e Shoqërimit për në Laborator.</p>	22.04.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	---------	--------

			<p>do ta njihnit Ju një rezultat nga laboratorët e njohur europianë, p.sh.: E**** Sc****; S** ose laboratorë të tjerë të ngjashëm?</p> <p>6. Përse ushtrohet ky bllokim dhe presion joproporcional kundrejt një produkti me origjinë bimore, ku rrezikshmëria është minimale?</p>	<p>Bazuar mostrave të kampionuara në PIK, duke përjashtuar origjinën nga Kosova, shpenzimet kryhen nga subjektet. Ndërsa, për produktet me origjinë nga Kosova, shpenzimet paguhën nga institucioni. Për sa i përket</p> <p>Për sa i përket mostrave të marra në PIK Morinë, gjithsej janë marrë 4 (<i>katër</i>) mostra, nga të cilat 2 (<i>dy</i>) kanë dalë rezultatet laboratorike dhe janë njoftuar rregullisht subjektet, ndërsa për 2 (<i>dy</i>) mostrat e tjera jemi ende në pritje.</p> <p>Mostrat janë marrë në kuadër të kontrollit zyrtar në zbatim të VKM-së nr.708, datë 09.09.2020 “<i>Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit</i>”, në Kreun III, pika 7, gërma ‘ç’), ku Autoriteti Kombëtar të Ushqimit siguron kryerjen e analizave në laboratorë të tjerë të akredituar, brenda ose jashtë vendit, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar. Referuar Urdhrit nr.851/2 Prot., datë 19.02.2026 “<i>Për monitorimin e produktit konservë bimore turshi</i>” mbi marrjen e mostrave importi dhe prodhim vendas në Terren dhe PIK, si dhe bazuar Planit të Masave me nr.851/1 Prot., datë 19.02.2026, për sa i përket kampionimit sipas subjekteve të përcaktuara, numrit të mostrave si dhe treguesit për të cilat dërgohen për analizimin e mbetjeve të pesticideve si dhe nivelin e metaleve të rënda:</p> <p>Analiza të ndryshme kanë kohëzgjatje të ndryshme. Duhet të theksohet fakti se këto analiza janë kryer në Laboratorë të akredituar jashtë vendit (në Itali) dhe ka patur zgjatje të procedurave, atyre doganore, kapaciteti</p>			
--	--	--	---	--	--	--	--

			<p>laboratorik në momentin e ardhjes së mostrës, etj., çka nuk lejon përcaktimin me saktësi të kohëzgjatjes, duke përfshirë këtu edhe rastet kur laboratorit mund të ketë domosdoshmëri të përsëritjes së analizës.</p> <p>Në të gjitha rastet kur mostra është marrë jashtë rregullave procedurale ligjore të marrjes së saj, subjekti ka të drejtë që të mos e pranojë rezultatin e analizës.</p> <p>Nëse një subjekt nuk bie dakort me rezultatin e analizës, ky i fundit kryen një kërkesë drejtuar institucionit, për përsëritje të saj, pra, <i>rianalizimi</i> i mostrës në ruajtje, në Laboratorin ku është analizuar (ku është marrë rezultati që subjekti nuk është dakord) <u>dhe jo rimarrje mostre</u>.</p> <p>Të gjitha analizat e tjera të kryera nga vetë subjekti, nuk merren parasysh në këtë rast (janë analiza autokontrolli dhe jo kontroll zyrtar).</p> <p>Sqarojmë se lidhur me rrezikshmërinë e produktit se i nënshtrohet kontrollit zyrtar për 2 komponentë mjaft të rëndësishëm në këndvështrimin e sigurisë ushqimore, pikërisht Udhëzimit nr.17, datë 25.04.2025 “<i>Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqimet dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore dhe shtazore</i>” dhe Udhëzimit nr.4, datë 09.02.2024 “<i>Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në ushqime</i>”.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

65.	07.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në vijim të njoftimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në muajin Mars 2026, lidhur me kontrollin e ushtruar pranë subjektit K***, ku u vendos masa e bllokimit e një sasive <i>mish pule</i> dhe u mor mostra për analizë mikrobiologjike, kërkohet informacion lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rezultatet e analizave të kryera për produktet e sekuestruara (fileto pule “S**** F*****” dhe gjoks pule “P*****”) dhe një kopje e analizave; – Nëse këto produkte rezultojnë të sigurta për konsum dhe nëse është hequr masa e bllokimit; ose – Nëse është vendosur asgjësimi i tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 	<p>Nga rezultatet e analizave të kryera për produktin <i>fileto pule</i> “S** F**” (nr. identifikues i mostrës: U-124-26), sipas Raport Provës së datës 26.03.2026, kanë rezultuar konforme, për këtë arsye, ndaj tyre është hequr masa e bllokimit.</p> <p>Nga rezultatet e analizave të kryera për produktin <i>gjoks pule</i> “P***” (numri identifikues i mostrës: U-125-26), sipas Raport Provës së datës 19.03.2026, kanë rezultuar konforme, për këtë arsye, ndaj tyre është hequr masa e bllokimit.</p> <p><i>Në lidhje me kërkimin për një kopje të analizave laboratorike</i>, duke sjellë në vëmendje se ato kanë rezultuar konforme, ky dokumentacion përmban të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve, ndaj trajtohet me kujdes të veçantë dhe mbrohet në përputhje me ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar) si dhe me nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), i cili parashikon kufizime të së drejtës për informim në rastet kur publikimi mund të çenojë privatësinë dhe të dhënat personale të individëve. Po kështu, në zbatim të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar) dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si autoritet publik, ka detyrimin ligjor të mbrojtjes së të dhënave që lidhen me jetën private dhe aktivitetin profesional të subjekteve. Në këtë kuadër, drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale janë të drejta të ndërlidhura ngushtësisht, ku respektimi i njërës nuk mund dhe nuk duhet të çenojë garantimin e tjetrës.</p>	20.04.2026	e kufizuar	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	--	------------	------------	--------

66.	07.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Referuar produkteve ushqimore (12 kampione) konserva turshi (të marra në mënyrë rastësore në markete të ndryshme) ku trajtohet jokonformiteti i konstatuar nga një laborator privat analizues, si dhe pas marrjes në shqyrtim të rastit nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit duke u hartuar një plan masash për monitorimin e situatës jo vetëm për produktet e importit por dhe për prodhimin vendas me qëllim vlerësimin dhe menaxhimin e riskut duke kryer procedurat e marrjes së mostrave për analizimin e mbetjes së pesticideve dhe metaleve të rënda në produktet konserva bimore “Turshi” të llojeve të ndryshme për analizim në një laborator në Itali, kërkojmë nga ana Juaj vënien në dispozicion të raport-analizave nga laboratorit italian si dhe masat e ndërmarra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.</p>	<p>Në zbatim të Planit të Punës dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë kryer inspektime pranë subjekteve prodhuese dhe importuese të produktit “Turshi”, me objekt: <i>Inspektime, marrje mostre për analizim për treguesit e mbetjeve të pesticideve dhe nivelin e metaleve të rënda. Në total, rezulton se janë marrë 28 (njëzet e tetë) mostra</i>, konkretisht 12 (<i>dymbëdhjetë</i>) mostra në subjekte importuese dhe 16 (<i>gjashtëmbëdhjetë</i>) mostra në subjekte prodhuese e tregtuese të produktit “Turshi”.</p> <p>Kështu, në zbatim të VKM-së nr.708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, sipas parashikimeve të përcaktuara në Kreun III, pika 7, gërma ‘ç)’ e saj, ku Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, siguron kryerjen e analizave në laboratorë të tjerë të akredituar, brenda ose jashtë vendit, analizimi i të gjitha mostrave të marra është kryer në një Laborator në Itali, mbi: “Mbetje të pesticideve dhe nivelin maksimal të metaleve të rënda”.</p> <p>Në përgjigje të këtyre rezultateve, nga 28 (<i>njëzet e tetë</i>) mostra të marra në total, 24 (<i>njëzet e katër</i>) mostra kanë rezultuar <u>konforme</u> ndërsa 4 (<i>katër</i>) kanë rezultuar <u>jokonforme</u>. Në lidhje me këto të fundit (mostrat jokonforme), Ju bëjmë me dije se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë të gjitha masat e nevojshme konform legjislacionit në fuqi, ndaj OBU-ve përkatëse.</p>	20.04.2026	e kufizuar	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	------------	--------

			<p>Së fundmi, <i>në lidhje me kërkimin Tuaj për një kopje të raport-analizave laboratorike</i>, ky dokumentacion përmban të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve, ndaj trajtohet me kujdes të veçantë dhe mbrohet në përputhje me ligjin nr.124/2024 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>” (i ndryshuar) si dhe me nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>” (i ndryshuar), i cili parashikon kufizime të së drejtës për informim në rastet kur publikimi mund të çënojë privatësinë dhe të dhënat personale të individëve. Po kështu, në zbatim të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar) dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si autoritet publik, ka detyrimin ligjor të mbrojë të dhënat që lidhen me jetën private dhe aktivitetin profesional të subjekteve.</p> <p>Në këtë kuadër, e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale janë të drejta të ndërlidhura ngushtësisht, ku respektimi i njërës nuk mund dhe nuk duhet të çënojë garantimin e tjetrës. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, është i detyruar të veprojë në përputhje me këto parime dhe dispozita ligjore për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe përdorimin e drejtë të informacionit që administron.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

67.	15.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti parashtron se në datën 18.03.2026, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka njoftuar për tërheqjen nga tregu të qumështit Ap***** i identifikuar si i kontaminuar me toksinën cereulide dhe me rrezik për shëndetin e fëmijëve.</p> <p>Në lidhje me këtë rast, kërkohet informacion sipas pyetjeve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Në cilën datë të saktë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është njoftuar përmes sistemit 'RASFF' për rrezikun që paraqiste ky produkt? Përse nuk është bërë njoftimi publik menjëherë pas marrjes së informacionit për rrezikun, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e lartë të konsumatorëve (foshnjat)? Njoftimi nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është bërë më datë 18.03.2026, ndërkohë që subjekti e ka asgjesuar produktin në datë 13.03.2026. Kush mban përgjegjësi institucionale dhe individuale për vonesën midis datës së asgjësimit të produktit dhe njoftimit publik? A ka patur vlerësim të riskut për pasojat që mund të kishte 	<p>Në përgjigje të pyetjes së parë, njoftimi fillestar nga sistemi 'RASFF' për Shqipërinë, në lidhje me problematikën e toksinës 'Cereulide' në formulat për foshnje të qumështit 'Ap*****', është bërë më datë 29 Janar 2026. Ky njoftim fillestar nuk përfshin subjektin të cilit i referoheni. Në vijim, ka patur disa njoftime përgjatë muajit Shkurt dhe Mars, në lidhje me shpërndarjen nga subjekte të ndryshme në Shqipëri për këtë produkt, të cilat janë raste të lidhura brenda të njejtit incident. Vlen të theksojmë se edhe vetë subjektet kanë njoftuar Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, pas marrjes së njoftimit nga kompanitë prodhuese dhe kanë filluar tërheqjen nga pikat e tregtimit.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes së dytë, njoftimi i parë publik në lidhje me praninë e toksinës 'Cereulide' në formulat e qumështit, është bërë më datë 16 Janar 2026, për produktet e kompanisë 'N*****'. Për sa i përket qumështit 'Ap*****', i cili prodhohet nga kompania 'D*****', pas njoftimit fillestar nga sistemi 'RASFF' si dhe dhe pas marrjes së masave nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me bllokim, është kryer njoftimi për konsumatorin në faqen zyrtare web që në datën 06 Shkurt 2026, në rubrikën "Lajmet e fundit", duke specifikuar LOT/datë skadence të 'Ap*****'. Në datën 24 Shkurt 2026, është publikuar në rubrikën e njoftimeve 'RASFF', një tjetër njoftim në vijim të atyre të mëparshme. Ka disa njoftime të njëpasnjëshme për konsumatorin deri në muajin Mars, si në rubrikën "Lajmet e fundit" ashtu edhe në rubrikën e njoftimeve 'RASFF', të cilat i referohen produktit 'Ap*****' me LOT-e dhe data të ndryshme skadence.</p>	28.04.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	--	------------	---------	--------

			<p>konsumimi i këtij produkti gjatë periudhës së mungesës së njoftimit?</p> <p>5. Çfarë masash janë marrë nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për të njoftuar prindërit që kanë blerë produktin e kontaminuar?</p> <p>6. A është kryer ndonjë hetim i brendshëm administrativ për këtë rast dhe cilat janë rezultatet paraprake?</p> <p>7. A janë marrë masa disiplinore apo procedurale ndaj personave përgjegjës për këtë situatë?</p>	<p><i>Në përgjigje të pyetjes së tretë,</i> asgjësimi të cilit i referoheni më datë 13.03.2026, ka të bëjë me disa Lote të produkteve ‘Ap*****’, të cilat janë bllokuar në muajin Shkurt, referuar njoftimit të ardhur nga sistemi ‘RASFF’ (gjithashtu edhe njoftimit nga vetë subjekti, po në muajin Shkurt). Njoftimi për konsumatorin në lidhje me këtë rast, është bërë në muajin Shkurt. Për sa i përket njoftimit për konsumatorin më datë 18.03.2026, ky njoftim nuk lidhet me asgjësimin e ndodhur më datë 13.03.2026, por ka të bëjë me Lot-e shtesë të qumështit ‘Ap*****’.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së katërt,</i> theksojmë se në asnjë rast nuk ka patur mungesë njoftimi nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit që të ekspozonte konsumatorët ndaj këtij risku, kjo pasi njoftimet janë përcjellë në kohë reale, në përputhje me procedurat e sistemit të sigurisë ushqimore. Në këtë situatë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha subjektet shpërndarëse, duke tërhequr produktet nga raftet dhe duke njoftuar konsumatorët për problematikën e paraqitur, në mënyrë që në një situatë ku ndjeshmëria ishte akoma më e madhe sepse bëhej fjalë për produkte për foshnje, të menaxhohej në kohë dhe në përputhje me procedurat e sigurisë ushqimore.</p> <p>Paralelisht, është kryer edhe vlerësimi i riskut nga Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore, i cili është bërë publik në faqen zyrtare të institucionit (www.aku.gov.al) dhe është përdorur si bazë për marrjen e masave parandaluese dhe menaxhimin e situatës nga autoritetet përkatëse.</p>			
--	--	--	---	---	--	--	--

			<p>Kompanitë prodhuese si ‘N*****’ dhe ‘D*****’, tërhoqën një sërë lot-esh formulë për foshnja, për shkak të pranisë së mundshme të toksinës ‘Cereulide’, e lidhur me një përbërës të jashtëm (vaj ARA). Në vijim, konfirmuan problematikën në nivel zinxhiri furnizimi dhe në disa lot-e specifike ku u detektuan gjurmë të toksinës ‘Cereulide’. Megjithatë, ato vazhduan ta cilësonin situatën si rrezik potencial, duke theksuar karakterin parandalues të tërheqjeve. Problemi u trajtua si një çështje sigurie në zinxhirin e furnizimit, me kontrole dhe testime të shtuara për të garantuar sigurinë e konsumatorëve.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së pestë</i>, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bërë njoftime të njëpasnjëshme në faqen zyrtare për konsumatorët; ka publikuar materiale informuese në lidhje me toksinën ‘Cereulide’; dhe njoftime të vetë kompanive prodhuese me <i>pyetje&përgjigje</i>. Të gjitha subjektet tregtuese, kanë njoftuar konsumatorët në pikat e tregtimit, për tërheqjen dhe kthimin mbrapsht të produkteve.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë</i>, në lidhje me njoftimet të cilat Ju i referoheni, është ndjekur procedura sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk ka patur shkelje të procedurave. Kështu, <i>në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, masat disiplinore merren në rastet kur evidentohen shkelje të procedurave (të ndjekjes së njoftimeve). Në rastin konkret, nuk janë konstatuar shkelje administrative apo procedurale, kjo pasi situata është trajtuar në përputhje me kërkesat dhe legjislacionin në fuqi.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

68.	17.04.2026	Kërkesë për bashkëpunim	Një portal lajmesh <i>online</i> ofron mundësi bashkëpunimi për promovim dhe marketing në disa platforma.	Në përputhje me strukturën organizative dhe organikën e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, çështjet që lidhen me menaxhimin e komunikimit publik, përfshirë administrimin e rrjeteve sociale, promovimin dhe aktivitetet e tjera të ngjashme, mbulohen nga Sektorë të posaçëm brenda institucionit.	20.04.2026	e plotë	nuk ka
69.	20.04.2026	Kërkesë për ndërhyrje (<i>rast i referuar</i>)	Në referim të situatave të shumta të reklamimit të suplementeve ushqimore si <i>shëruese</i> të shumë problemeve apo sëmundjeve, si dhe duke e konsideruar shumë të nevojshme ndërhyrjen e menjëhershme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, kërkojmë monitorimin dhe ndalimin e reklamimit të suplementeve në fjalë “ <i>me ndikim në shëndet</i> ”, pa u siguruar më parë nga prodhuesit dhe importuesit e tyre, barra e provës.	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka në fokusin e tij qendror, <u>sigurinë e konsumatorit shqiptar në përputhje me legjislacionin në fuqi</u> . Është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU) që importon, trajton dhe tregton produkte ushqimore, për të siguruar zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kriterëve ligjore, së bashku me dokumentacionin e rregullt, sipas: <ul style="list-style-type: none"> • ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (<i>i ndryshuar</i>); • ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”; • VKM-së nr.434, datë 11.07.2018 “<i>Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit</i>”; • VKM-së nr.760, datë 16.09.2015 “<i>Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit, ushqimit për kafshë, përgjatë zinxhirit ushqimor</i>”. <p>Sqarojmë se AKU është institucioni përgjegjës për sa i takon kontrollit për garantimin e kërkesave sipas legjislacionit të sipërcituar, konkretisht importit dhe tregtimit të produkteve (në rastin konkret, suplementeve ushqimore) me etiketë, ku të pasqyrohet informacioni ushqimor i detyrueshëm konform legjislacionit në fushën e ushqimit, si dhe dokumentacionin përkatës.</p>	24.04.2026	e plotë	nuk ka

			<p>Informacioni ushqimor, duhet të orientojë në mënyrë të drejtë, konsumatorin.</p> <p>Informacioni ushqimor i detyrueshëm shënohet në një vend të dallueshëm, në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i dukshëm, qartësisht i lexueshëm dhe të mos fshihet. Në asnjë mënyrë, ai nuk duhet të jetë i fshehur, i errësuar, i kufizuar apo të ndërpritet nga ndonjë material tjetër i shkruar, imazh apo element ndërhyrës. OBU, është përgjegjës për informacionin ushqimor. Në rastin e produkteve ushqimore të importuara (suplemente ushqimore), përgjegjës për informacionin ushqimor është importuesi i tij, si dhe tregtuesit që zakonisht janë njësitë farmaceutike. Për produktet ushqimore të importuara, deklarimi i të dhënave të informacionit ushqimor duhet të jepet në gjuhën shqipe, në etiketën origjinale ose në kundëretiketë.</p> <p>Për sa më sipër sqaruar, AKU nuk është institucioni përgjegjës për sa i takon reklamimit të vetive mjekësore (kurative apo shëruese) të produkteve, konkretisht “reklamimit në TV apo radio të shërimit të problemeve me gjunjët, kockat, veshkat, zemrën, prostatën, mëlçinë apo sëmundjeve dhe patologjive të ndryshme, si dhe përdorimit të imazhit të mjekëve të njohur”, të cilat janë ekskluzivisht kompetencë e institucioneve shëndetësore, pasi këto suplemente ushqimore, janë produkte të destinuara për t’iu integruar dietës normale, duke e plotësuar me ushqyes si vitamina, minerale, barëra, aminoacide, apo enzima të koncentruara në forma</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			<p>të ndryshme (kompresa, pluhur, lëngje, etj.), gjithmonë me rekomandimin e personelit të specializuar shëndetësor në lidhje me llojin, sasinë, si dhe kohëzgjatjen e përdorimit, duke patur parasysh specifikën e konsumatorëve (mosha apo rrethana të ndryshme personale).</p> <p>Për sa i takon Autoritetit të Mediave Audiovizive, ky shqetësim duhet të adresohet pranë këtyre institucioneve.</p> <p>Ju bëjmë me dije se bazën ligjore të përmendur më sipër, si dhe akte të tjera nënligjore, i gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, tek ‘Legjislacioni’: www.aku.gov.al</p>				
70.	21.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në lidhje me produktin ushqimor për foshnje “A**”, për sa i përket periudhës 01 Dhjetor 2025 – 31 mars 2026, kërkoj informacion:</p> <p>1. A ka marrë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, njoftime, alarme apo komunikime zyrtare lidhur me produktet “A**” gjatë kësaj periudhe? Të specifikohet data e njoftimit të parë dhe burimi i tij.</p> <p>2. Cilat produkte “A**” janë importuar, shpërndarë ose tregtuar në Shqipëri gjatë kësaj periudhe? Të specifikohet emri i produktit, numri i lotit, vendi i origjinës, importuesi dhe sasia.</p>	<p>1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë njoftim më datë 29.01.2026 nga sistemi ‘RASFF’, fillimisht për produktin “A**” me origjinë nga Gjermania dhe lëndë të parë nga Irlanda. Në njoftimet që pasuan, lista e produkteve u zgjerua edhe më shumë, duke përfshirë produktet “A**”, të renditura në përgjigjen e pyetjes 2 më poshtë.</p> <p>2. Në Shqipëri janë importuar produkte “A**” me lot-e, data skadence dhe vende origjine të ndryshme, nga kompani të ndryshme importuese, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Importuar nga subjekti “L*** C****” SHPK (origjina Poloni, Irlandë, Holandë); - Importuar nga subjekti “R***&L****” SHPK (origjina Gjermani, lëndë e parë Irlandë); - Importuar nga subjekti “CONAD” (origjina Holandë). 	28.04.2026	e kufizuar	nuk ka

		<p>3. A ka urdhëruar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, tërheqje nga tregu, bllokim, pezullim shitje apo masa të tjera ndaj produkteve “A***”? Nëse po, cilat produkte dhe në çfarë datash?</p> <p>4. A janë marrë mostra për analizë laboratorike nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për produktet “A***”? Nëse po, cilat produkte janë testuar, në cilat data dhe cili laborator i ka kryer analizat?</p> <p>5. Cilat kanë qenë rezultatet e analizave laboratorike? A është konstatuar prani e <i>Bacillus cereus</i>, <i>Cereulide</i> apo ndonjë rrezik tjetër për sigurinë ushqimore?</p> <p>6. Sa kontrole ose inspektime janë kryer nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit tek farmacitë, marketet, distributorët apo magazinat lidhur me produktin “A***” dhe a janë sekuestruar / asgjësuar produkte?</p> <p>7. A ka marrë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ankesa nga konsumatorët, raportime për probleme shëndetësore apo sinjalizime të tjera lidhur me përdorimin e produkteve “A***” në Shqipëri?</p> <p>8. Çfarë komunikimi ka patur Autoriteti Kombëtar i Ushqimit</p>	<p>3. Menjëherë me marrjen e njoftimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer inspektime në terren pranë subjekteve, me qëllim verifikimin dhe ndjekjen e gjurmueshmërisë së këtyre produkteve. Megjithëse Operatorët e Bizneseve Ushqimore (OBU), kishin filluar me tërheqjen vullnetare të produkteve nga tregu, sipas LOT-eve dhe datave të skadencës, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, pas verifikimeve në terren, ka vijuar me konstatimin e tërheqjes nga tregu të produktit dhe bllokimin e tij, deri në momentin kur OBU, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka kryer asgjësimin e produktit.</p> <p>Në lidhje me pyetjen 4, sqarojmë se nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk janë marrë mostra, për arsye se nga vetë sistemi ‘RASSF’, jemi informuar për praninë e substancës ‘<i>Cereulide</i>’ në formulë për fëmijë dhe formulë pasuese, të analizuar në Laboratorë të BE.</p> <p>Në lidhje me pyetjen 5, sikurse më lart trajtuar, nga rezultati i analizave të kryera në stabilimentet prodhuese të vendeve të BE, është konstatuar prania e substancës ‘<i>Cereulide</i>’ në formulë për fëmijë dhe formulë pasuese.</p> <p>6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole pranë subjekteve importuese duke ndjekur gjurmueshmërinë e produktit, deri në çdo kthim të tij. Po kështu, është proceduar me bllokimin e sasisë së produkteve të kthyera duke u kryer më pas, procedura e asgjësimit, sipas parashikimeve të nenit 69 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar).</p>			
--	--	---	--	--	--	--

			<p>me importuesit, distributorët apo përfaqësuesit e prodhuesit lidhur me këtë rast?</p> <p>9. Çfarë njoftimesh publike ka bërë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për konsumatorët, lidhur me këtë rast dhe pse nuk janë publikuar në mënyrë të plotë lotet, analizat apo dokumentacioni teknik, nëse ekzistojnë?</p> <p>10. Kërkojmë kopje elektronike të çdo dokumenti që lidhet me këtë rast, përfshirë urdhra tërheqje, procesverbale inspektimi, raporte laboratorike dhe shkresa zyrtare.</p>	<p>Në lidhje me pyetjen 7, sqarojmë se pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit kanë mbërritur vetëm kërkesa për informacion lidhur me rastin, por jo ankesa apo raportime të tjera në drejtim të problemeve shëndetësore.</p> <p>8. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka patur komunikime dhe takime me përfaqësuesit e kompanisë ‘Nestle’ në Shqipëri (në muajin janar) dhe ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha subjektet shpërndarëse, duke tërhequr produktet nga raftet dhe duke njoftuar konsumatorët për problematikën e paraqitur, në mënyrë që, në një situatë ku ndjeshmëria ishte akoma më e madhe pasi bëhej fjalë për produkte për foshnje, të menaxhohej në kohë dhe në përputhje me procedurat e sigurisë ushqimore. Disa prej subjekteve ishin njoftuar edhe nga kompanitë prodhuese apo shpërndarëse, duke filluar kështu tërheqjen vullnetare të produkteve nga tregu.</p> <p>9. Në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë publikuar herë pas here njoftime mbi LOT-et dhe datat e skadencës të ndryshme, sipas vendeve të origjinës së produktit, me qëllim kthimin mbrapsht të tij. Për të gjitha rastet, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka njoftuar nëpërmjet faqes zyrtare, duke filluar nga muaji Janar në lidhje me problematikën e toksinës ‘Cereulide’ në formulat për foshnje të qumështit. Në vijim, ka patur disa njoftime për konsumatorin përgjatë muajve Shkurt dhe Mars, në lidhje me shpërndarjen nga subjekte të ndryshme në Shqipëri për këtë produkt, të cilat janë raste të lidhura brenda të njëjtit incident.</p>			
--	--	--	--	--	--	--	--

			<p>Njoftimi i parë publik në lidhje me praninë e toksinës ‘Cereulide’ në formulat e qumështit, është bërë në datën 16 Janar 2026.</p> <p>Për sa i përket qumështit ‘A*****’, i cili prodhohet nga kompania ‘D****e’, pas njoftimit fillestar nga sistemi ‘RASFF’ dhe pas marrjes së masave nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me bllokim, është bërë njoftimi për konsumatorin në faqen zyrtare <i>web</i> që prej datës 6 Shkurt 2026 në rubrikën “Lajmet e fundit”. Ekzistojnë disa njoftime të njëpasnjëshme për konsumatorin deri në muajin Mars, si në rubrikën “Lajmet e fundit”, ashtu edhe në rubrikën e njoftimeve ‘RASFF’, të cilat i referohen produktit ‘A*****’ me Lot-e dhe data të ndryshme skadence. Në këto njoftime, konsumatori është këshilluar për kthimin mbrapsht nëse i dispononte produktet gjendje.</p> <p>Së fundmi, në lidhje me kërkimin Tuaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit (“duke përfshirë urdhra tërheqje, procesverbale inspektimi, raporte laboratorike dhe shkresa zyrtare”), ato përmbajnë të dhëna të detajuara me karakter teknik e tregtar të mbrojtur. Në zbatim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, konkretisht ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar) si dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale e sekretit tregtar, ky lloj dokumentacioni përjashtohet nga dhënia për palë të treta, pasi cenon interesat legjitime të subjekteve, si dhe integritetin e procedurave administrative e inspektuese.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

71.	27.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Lidhur me sigurinë e produkteve ushqimore për bebe që tregtohen në Shqipëri, duke u nisur nga raportimet e fundit për tërheqjen nga tregu në disa vende evropiane të disa serive të produkteve për bebe të kompanisë H***, për shkak të dyshimeve për kontaminim me substanca toksike (rodenticide), kërkoj informacion sa më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A janë importuar dhe tregtuar në Shqipëri produkte të kompanisë H*** nga të njëjtat seri (lote) që janë tërhequr nga tregu në vendet e Bashkimit Evropian? 2. A ka kryer Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kontrolle apo analiza laboratorike specifike për produktet H*** që tregtohen në Shqipëri? Nëse po, cilat janë rezultatet? 3. A është sinjalizuar Shqipëria përmes sistemit 'RASFF' në lidhje me këtë rast që lidhet me produktet H***? 4. Çfarë masash janë marrë nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të garantuar sigurinë e konsumatorëve, veçanërisht të foshnjave, në lidhje me këto produkte? 	<p>Në trajtim të kërkesës për informacion, nuk rezulton asnjë njoftim që produktet e kompanisë "H***", të jenë importuar nga Operatorë të Biznesit Ushqimor (OBU) të cilët operojnë në vendin tonë. Po kështu, në Planin me Bazë Risku, nuk rezulton të ketë mostra të planifikuara për analizimin e tregtuesve analitikë (substanca toksike) në lidhje me problematikën e këtyre produkteve. Edhe nga Drejtoria e Vlerësimit të Riskut, nuk rezulton të ketë asnjë njoftim për ndonjë rast 'alert' mbi këto produkte. Së fundmi, nuk rezulton asnjë njoftim zyrtar nga sistemi 'RASFF', në lidhje me produktet 'H***'.</p> <p>Për sa më sipër sqaruar, deri në këtë moment, nuk disponohet asnjë njoftim zyrtar, qoftë nëpërmjet sistemit 'RASFF' apo strukturave të brendshme të monitorimit dhe vlerësimit të riskut, në lidhje me produktet e kompanisë "H***" që të paraqesin rrezik për shëndetin e konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, nuk rezulton që produkte nga lot-et e raportuara në vendet e Bashkimit Evropian të jenë importuar apo tregtuar në vendin tonë.</p> <p>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vijon të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme bazuar në analizën e riskut dhe mbetet i angazhuar për të garantuar sigurinë ushqimore, veçanërisht për kategoritë më të ndjeshme si foshnjat.</p> <p><i>Në rast të çdo njoftimi apo alerti të mundshëm në të ardhmen, do të merren menjëherë masat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i></p>	04.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	---	------------	---------	--------

72.	30.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>1. Sipas kuadrit ligjor në fuqi, a është e lejueshme që data e skadencës në produktet ushqimore të jetë e shlyeshme (e fshishme)?</p> <p>2. Cilat janë kriteret teknike që duhet të plotësojë kjo datë për t'u konsideruar “e pashlyeshme”?</p> <p>3. Sa inspektime ka kryer AKU gjatë periudhës Janar 2025 - Prill 2026, me fokus të veçantë në verifikimin e integritetit të etiketave dhe datave të skadencës në pikat e shitjes me pakicë dhe shumicë?</p> <p>4. Në sa raste janë konstatuar shkelje ku data e skadencës ishte e shlyeshme (e fshishme)?</p> <p>5. Sa masa administrative janë marrë për këtë shkelje?</p> <p>6. Sa është vlera totale e gjobave të vendosura?</p> <p>7. A ka dijeni AKU për përdorimin e pajisjeve apo substancave kimike nga operatorët ekonomikë për fshirjen e datave origjinale dhe rishtypjen e tyre?</p> <p>8. Nëse po, a janë sekuestruar pajisje të tilla në inspektime?</p> <p>9. Cilat janë hapat që duhet të ndjekë një konsumator kur konstaton në raftet e dyqaneve, produkte me datë skadence të fshishme?</p>	<p>Fillimisht, sqarojmë se misioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është garantimi i sigurisë ushqimore për të gjithë konsumatorët. Ky proces është dinamik, duke reflektuar në problematikat e ndryshme që hasen, ndiqet dita-ditës dhe rast pas rasti, duke patur për qëllim të vetëm: evidentimin, shmangien dhe eliminimin e çdo faktori që mund të cenojë sigurinë ushqimore.</p> <p>Pra, edhe fenomeni i konstatimit të produkteve ushqimore, etiketa e të cilave, për sa i përket datës së skadencës (nëse fshihet apo jo, është jo e dukshme/e qartë, apo në rastet e manipulimit të tyre), janë pjesë e punës së pandalshme të veprimtarisë së trupave inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, gjatë ushtrimit të kontrolleve zyrtare (inspektimeve).</p> <p>Vlen të theksojmë edhe rëndësinë e madhe që ka në fokus, edhe shkalla e ndërgjegjësimit të vetë konsumatorëve. Këta të fundit, duhet të jenë të ndërgjegjshëm jo vetëm me qëllim për të shmangur produktet e pasigurta apo subjektet që i prodhojnë apo tregtojnë këto produkte, por gjithashtu duhet të jenë aktivë për denoncimin e tyre në rastet kur evidentojnë fenomenin e fshirjes apo mosdukjes qartë të datës së skadencës (apo të dhënave të tjera), duke i adresuar pranë strukturave përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit – si dhe organeve të tjera kompetente kur kemi të bëjmë me raste të mashtrimit, falsifikimit apo veprave të tjera të ngjashme penale.</p>	13.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	--	------------	---------	--------

Duke iu rikthyer pyetjes së parë të parashtruar, sqarojmë se ligji nr.9863, datë 28.01.2008 “*Për Ushqimin*” (i ndryshuar), normon detyrimet dhe përgjegjësitë e subjekteve, specifikisht neni 1, gërma ‘b’): “*Ky ligj ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, duke përcaktuar: [...] b) detyrimet e operatorëve të biznesit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, për higjienën dhe sigurinë e këtyre ushqimeve; [...]*”; neni 3, pika 3: “*Operator i biznesit ushqimor*” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin ushqimor, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë arritur në biznesin ushqimor të kontrolluar prej tij”; neni 3, pika 6: “*Operator i biznesit ushqimor për kafshë*” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin e ushqimit për kafshë, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë plotësuar në biznesin e kontrolluar prej tij”; dhe neni 24, pika 1: “*Nëse një operator i biznesit ushqimor vlerëson se një ushqim, të cilin ai e ka importuar, prodhuar, përpunuar, shpërndarë apo nxjerrë në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore apo dëmton shëndetin e njerëzve, ai menjëherë fillon procedurat për heqjen e ushqimit në fjalë nga tregu dhe vë në dijeni strukturën përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë dhe ministrin përgjegjës për ushqimin. [...]*”.

			<p>Referuar legjislacionit në fuqi mbi etiketimin e produkteve ushqimore, konkretisht VKM nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, përcakton në Kreun IV të saj “Informacionin e detyrueshëm ushqimor”, konkretisht, Seksioni 1 “Përmbajtja dhe paraqitja”, neni 13 normon paraqitjen e veçorive të detyrueshme, se: “1. Informacioni ushqimor i detyrueshëm shënohet në një vend të dallueshëm, në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i dukshëm, qartësisht i lexueshëm dhe të mos fshihet. Në asnjë mënyrë ai nuk duhet të jetë i fshehur, i errësuar, të kufizohet apo të ndërpritet nga ndonjë material tjetër i shkruar, imazh apo element ndërhyrës; 2. Pa rënë ndesh me dispozitat specifike të legjislacionit në fuqi, të zbatueshme për produkte ushqimore të veçanta, kur shfaqen në paketim ose në etiketën e ngjitur në të, veçoritë e detyrueshme, të renditura në pikën 1, të nenit 9, printohen në paketim ose në etiketë, në mënyrë të tillë që të garantohet lexueshmëria e qartë, me shkronja me madhësi shkrimi ku lartësia x është e barabartë ose më e madhe se 1,2 mm, siç përcaktohet në shtojcën IV bashkëlidhur këtij vendimi; 3. Në rastin e paketimit ose të enëve me sipërfaqe totale më të vogël se 80 cm², lartësia x e madhësisë së shkrimit, të përmendur në pikën 2, është e barabartë ose më e madhe se 0,9 mm; 4. Veçoritë e përcaktuara në shkronjat “a”, “d” dhe “gj”, të pikës 1, të nenit 9, shfaqen në të njëjtën fushëpamje; 5. Pika 4 e këtij neni nuk zbatohet në rastet e specifikuar në pikat 1 e 2 të nenit 16”.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>Pra, në aspektin ligjor, është përcaktuar qartë detyrimi i Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) për tregtimin e produkteve ushqimore me etiketim të rregullt, qartësisht të lexueshëm dhe që nuk fshihet.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së dytë</i>, në lidhje me kriteret teknike, VKM-ja nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, ka për qëllim të vendosë bazën për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh dallimet në perceptimin e konsumatorëve dhe nevojat e tyre për informacion, si dhe duke siguruar funksionimin normal të tregut. Kështu, ky vendim i Këshillit të Ministrave, përcakton qartë parimet e përgjithshme, kërkesat dhe përgjegjësitë kryesore që rregullojnë informacionin për ushqimin dhe, në veçanti, etiketimin e produkteve ushqimore.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, rezulton se përgjatë periudhës Janar 2025 - Prill 2026, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer në total 3,947 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) inspektime, në pikat e shitjes me pakicë dhe shumicë, ku pjesë e procedurës së inspektimit është edhe kontrolli i etiketave dhe datave të skadencës së produkteve.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së katërt</i>, nga verifikimet e kryera, sipas raportimeve të ardhura nga drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, rezulton se nuk ka patur raste të tilla.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p><i>Në përgjigje të pyetjes së pestë</i>, në lidhje me problematika të subjekteve mbi etiketimin apo etiketat e produkteve, rezulton se janë marrë në total 34 (<i>tridhjetë e katër</i>) masa administrative “<i>Gjobë</i>”, konform legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë</i> (si dhe në vijim të përgjigjes së pyetjes 5 më sipër), rezulton se vlera totale e masave administrative “<i>Gjobë</i>”, vendosur për këto raste, është në një total prej ALL 1,950,000 (<i>një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë lekë</i>).</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë dhe shtatë</i>, nëse Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka dijeni për përdorimin e pajisjeve apo substancave kimike nga operatorët ekonomikë, për fshirjen e datave origjinale dhe rishtypjen e tyre, <i>e nëse po</i>, a janë sekuestruar pajisje të tilla gjatë inspektimeve, sqarojmë se për sa i takon përdorimit të pajisjeve apo substancave kimike nga operatorët ekonomikë, për fshirjen e datave origjinale të skadencës dhe rishtypjen e tyre, ky rast është në kompetencë të hetimeve nga organet përkatëse ligjzbatuese dhe jo në kompetencë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, sikurse më lart sqaruar, në rastet kur konsumatori konstaton fenomenin e fshirjes apo mosdukjes qartë të datës së skadencës (apo të dhënave të tjera), duhet të referojë rastin nëpërmjet një denoncimi, pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

73.	30.04.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti i interesuar njofton për fillimin e aktivitetit të tij tregtar në fushën e përgatitjes dhe tregtimit të ushqimeve, si dhe të shërbimit bar-kafe.</p> <p>Lloji i aktivitetit tregtar: “<i>Bar-kafe, lëngje të shtrydhura, shërbime delivery dhe shërbime take and go</i>”</p> <p>Për sa më sipër, subjekti interesohet nëse kërkohen procedura apo dokumentacion shtesë me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore.</p>	<p>Subjektet që kryejnë aktivitet tregtar <u>me pakicë</u>, nuk licencohen, pra, nuk janë të detyruar të pajisen me licencë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Megjithatë, këto subjekte janë të detyruara të njoftojnë Drejtorinë Rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, mbi vendin e kryerjes së aktivitetit tregtar dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 (<i>tridhjetë</i>) ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë.</p> <p>Në rastin konkret, me anë të njoftimit Tuaj ky detyrim është ezauruar (përmbushur). Kështu, njoftimi do të përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit tek Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, me qëllim përfshirjen e subjektit tregtar në Planin Vjetor të inspektimeve, duke kryer kështu një inspektimi fillestar.</p> <p>Nëse subjekti kryen aktivitet <u>me shumicë</u> në fushën e ushqimit (prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për nënkategoritë II.1.A), ai është i detyruar që të bëjë kërkesën për regjistrim pranë QKB, ku edhe detyrohet të paraqesë dokumentacionin përkatës.</p> <p>Theksojmë faktin se është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU) që përgatit, përpunon, trajton, ruan, magazinon dhe shpërndan produkte ushqimore, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullave dhe standardeve të detyrueshme tekniko-teknologjike, në ambientet e tij, si dhe dokumentacion të rregullt të</p>	13.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	--	------------	---------	--------

			<p>produkteve ushqimore, kryesisht sipas këtij legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none">• ligji nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar);• Udhëzimi nr.22, datë 25.11.2010 “<i>Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor</i>”;• Udhëzimi nr.20, datë 25.11.2010 “<i>Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimentet ushqimore</i>”; dhe• VKM-ja nr.760, datë 16.09.2015 “<i>Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor</i>”. <p>Po kështu, sqarojmë se personeli që do të punojë në subjektin në fjalë duhet të pajiset me Librezë Shëndetësore, kjo e detyrueshme për çdo person i cili është pjesë e personelit që punon në fushën e trajtimit (prodhim, përpunim) apo shërbimit të ushqimit. Gjithashtu, për ujin i cili do të përdoret, nevojitet të kryhet një analizë për ngarkesën mikrobiologjike pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).</p> <p>Referuar miratimit higjieno-sanitar, lutemi të drejtohet një kërkesë pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë (bazuar në qarkun ku ushtron aktivitet subjekti).</p>		
--	--	--	---	--	--